

PËRMBAJTJA

- Këshilli i Lartë i Prokurorisë përmbyll procedurën për ngritjen në detyrë dhe emëron 8 (tetë) prokurorët e parë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
- Me emërimin e 8 prokurorëve të posaçëm KLP hap garën për zgjedhjen e Drejtuesit të SPAK. Anëtarët e Këshillit kanë miratuar metodologjinë për përzgjedhjen e prokurorëve të emëruar, të cilët do të shprehin interesin për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall thirrjen për t'u bërë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH): Hapen aplikimet për pozicionin e Drejtorit dhe hetuesit të BKH-së
- Gjykatat dhe Prokuroritë e Krimeve të Rënda përgatisin dosjet në kompetencë të Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme: 30 dosje në Gjykatat e Krimeve të Rënda me 212 të pandehur janë gati për në Gjykatat KKKO dhe 440 dosje do të kalojnë për hetim SPAK
- Procesi i rivlerësimit ende nuk ka përfunduar për të gjithë gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar: Ndërkohë ende janë në proces rivlerësimi 3 kandidatë aplikantë për prokurorë të posaçëm

SPAK Monitor është një kontribut i shoqërisë civile për të monitoruar, vlerësuar dhe informuar palët e interesuara dhe publikun mbi krijimin e Gjykatave të Posaçme dhe SPAK, si dhe për të sjellë këndvështrime dhe propozime që ndihmojnë në ecjen përpara të këtij procesi.

Numri i 6 (gjashtë) i SPAK Monitor trajton procesin e ngritjes në detyrë dhe emërimin e 8 prokurorëve të parë të Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Gjithashtu ky numër fokusohet edhe në procesin e aplikimeve për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme si edhe pozicionin e Drejtorit dhe hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH).

Në kohën kur krijimi i injëkohshëm i Gjykatave të Posaçme KKKO dhe SPAK përbën gjithashtu një nga fazat më të rëndësishme, në këtë numër të SPAK Monitor përshkruhen masat e ndërmarra nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Krimeve të Rënda (të dyja shkallët) sa i përket inventarizimit të dosjeve, të cilat do të kalojnë për kompetencë institucionale të reja kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Në të njëjtën kohë edhe harmonizimi i ritmeve të procesit të rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët e posaçëm përbën një komponent thelbësor në drejtim të konfirmimeve në detyrë dhe plotësimin të numrit ligjor për vendet vakante në organet e reja të hetimit dhe gjykimin.

Emërimi i 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe hapja e garës për pozicionin e Drejtuesit të këtij organi, hapa thelbësorë për fillimin e veprimtarisë së SPAK

Ngritja në detyrë e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjatë muajit nëntor 2019 konsiderohet një nga hapat më të rëndësishëm në drejtim të ngritjes së SPAK. Pas renditjes së 15 kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, KLP filloi gjatë muajit tetor procedurat për emërimin e 8 prokurorëve të parë në Prokurorinë e Posaçme.

Specifikisht, Komisioni i Posaçëm për ngritjen e SPAK pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë propozoi në mbledhjen e datës 25 tetor 2019, disa hapa në funksion të konstituimit të Prokurorisë së Posaçme (SPAK), me qëllim realizimin e tyre brenda një periudhe kohore 30 ditore, brenda muajit nëntor 2019.

Bazuar në propozimet më lart, në mbledhjen e datës 25 nëntor, e cila u zhvillua edhe me praninë e përfaqësuesve ndërkombëtarë të EURALIUS dhe OPDAT, KLP miratoi 8 projekt-aktet për emërimin e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme. 8 prokurororët e emëruar në Prokurorinë e Posaçme, do të kryejnë betimin në datën 19 dhjetor 2019 para Presidentit të Republikës, vendim i cili hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Pavarësisht se ligji parashikon përbërjen e Prokurorisë së Posaçme me të paktën 10 prokurorë dhe megjithëse respektimi i këtij numri ka qenë në mënyrë të vazhdueshme një çështje për diskutim edhe brenda vetë KLP-së, duke theksuar se emërimi i më pak se 10 prokurorëve të posaçëm nuk do të sjellë fillimin e funksionimit të SPAK. Struktura dhe numri i prokurorëve të posaçëm për fillimin e punës së institucionit do të përcaktohen vetëm nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili do të zgjidhet nga rradhët e prokurorëve të posaçëm, menjëherë pas

Këshilli i Lartë i Prokurorisë filloi gjatë muajit tetor procedurat për emërimin e 8 prokurorëve të parë në Prokurorinë e Posaçme.

Komisioni i Posaçëm për ngritjen e SPAK pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë propozoi në mbledhjen e datës 25 tetor 2019, hapat në funksion të konstituimit të Prokurorisë së Posaçme (SPAK), me qëllim realizimin e tyre brenda një periudhe kohore 30 ditore, brenda muajit nëntor 2019.

KLP emëroi në 25 nëntor 8 prokurororët e parë në Prokurorinë e Posaçme, të cilët do të kryejnë betimin në datën 19 dhjetor 2019 para Presidentit të Republikës, vendim i cili hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KLP hap zyrtarisht garën për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke shpallur thirrjen për shprehje interesi të prokurorëve të emëruar brenda një afati kohor prej 15 ditësh deri në datën 10 dhjetor 2019.

Kandidatët për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme do të vlerësohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në plotësimin e 7 kritereve mbi të cilat do të realizohet përzgjedhja e Drejtuesit të SPAK.

emërimit të tyre.

Në këtë mënyrë, me emërimin e 8 prokurorëve të posaçëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë në po të njëjtën mbledhje të datës 25 nëntor ka hapur zyrtarisht garën për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke shpallur thirrjen për shprehje interesi të prokurorëve të emëruar brenda një afati kohor prej 15 ditësh deri në datën 10 dhjetor 2019.

KLP ka miratuar nëpërmjet Vendimit Nr. 237 të datës 25.11.2019 edhe metodologjinë që do ndiqet për sa i përket përzgjedhjes së drejtuesit të SPAK me qëllim orientimin e anëtarëve të KLP në vlerësimin e kandidatëve për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme.

Përveç dokumentacionit që u kërkohet, kandidatët për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme do të vlerësohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në plotësimin e 7 kriterëve mbi të cilat do të realizohet përzgjedhja e Drejtuesit të SPAK duke përfshirë:

- 1) Eksperiencën në ndjekjen e çështjeve sensitive;
- 2) Eksperiencën dhe aftësinë në organizim dhe drejtim struktural;
- 3) Eksperiencën në hartimin e rregulloreve dhe çështjeve administrative;
- 4) Eksperiencën në çështje me ndjeshmëri të lartë publike ku është dashur edhe bashkëpunimi me median;
- 5) Eksperiencën në menaxhimin e burimeve njerëzore;
- 6) Vizioni dhe plani që do të ndjekin për krijimin e Prokurorisë së Posaçme dhe
- 7) Imazhin publik të kandidatëve.

Kandidatët për Drejtues të SPAK do të vlerësohen me 0 deri në 3 pikë në 7 kriteret e sipërcituara të paracaktuara në metodologjinë e vlerësimit. Ndërkohë, përveç kriterëve më lart, Këshilli ka vendosur një instrument shtesë vlerësimi, i cili lidhet me intervistat me kandidatët për drejtues të SPAK sipas datave dhe renditjes të përcaktuar paraprakisht. Këto të fundit do të jenë një instrument i vlerësimit në tërësinë e figurës publike të kandidatëve, përveç 7 kriterëve të paracaktuara me ligj dhe në metodologjinë e vlerësimit. Megjithatë, intervista nuk do të jetë pjesë e pikëzimit.

Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme do të zgjidhen për një mandat 9 vjeçar pa të drejtë riemërimi dhe Këshilli ka propozuar që çdo anëtar të votojë secilin kandidat për drejtues të SPAK duke shpjeguar pikëzimin e tij për çdo kandidat, në një formular pikëzimi pas momentit që do të njihen me platformën konkurruese të secilit. Vetë kryetari i KLP ka propozuar që zgjedhja e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme të kalojë nga Këshilli, jo vetëm si vendimarrje nga Komisioni i Posaçëm në Këshill.

Në përfundim të hapave të sipërpërmendur si edhe intervistave me kandidatët për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme, secili nga anëtarët e Këshillit vlerëson kandidatët sipas formularit bashkëlidhur në metodologjinë e vlerësimit. Maksimumi i pikëve që mund të grumbullojë një kandidat nga secili anëtar i Këshillit është 21.

Përveç zgjedhjes së Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, një hap tjetër i rëndësishëm është edhe ngritja e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), një strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme dhe përbëhet nga Drejtori, hetuesit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore.

KLP ka miratuar nëpërmjet Vendimit Nr. 237 të datës 25.11.2019 edhe metodologjinë që do ndiqet për sa i përket përzgjedhjes së Drejtuesit të SPAK.

Kandidatët për Drejtues të SPAK do të vlerësohen me 0 deri në 3 pikë në 7 kriteret e përcaktuara në metodologjinë e vlerësimit duke përfshirë intervistat sipas datave dhe renditjes të përcaktuar paraprakisht.

Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme do të zgjidhen për një mandat 9 vjeçar pa të drejtë riemërimi dhe Këshilli ka propozuar që çdo anëtar të votojë secilin kandidat për drejtues të SPAK duke shpjeguar pikëzimin e tij për çdo kandidat, në një formular pikëzimi pas momentit që do të njihen me platformën konkurruese të secilit.

Në përfundim të hapave si edhe intervistave me kandidatët për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme, secili nga anëtarët e Këshillit vlerëson kandidatët sipas formularit bashkëlidhur në metodologjinë e vlerësimit.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka filluar gjithashtu paraprakisht procedurat për ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) për pozicionet e Drejtorit dhe 60 hetuesve të BKH-së.



Në këtë mënyrë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka filluar paraprakisht procedurat për ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit duke publikuar në faqen e institucionit një informacion për të interesuarit për t'u bërë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) për pozicionet e Drejtorit dhe hetuesve të BKH-së, numri i të cilëve është përcaktuar të jetë 60.

Ndërkohë, tashmë kur me emërimin e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme dhe hapjen e thirrjes për zgjedhjen e Drejtuesit të këtij institucioni pritet të fillojë veprimtarinë një nga organet më të rëndësishme të hetimit në vend, Prokuroritë e Krimeve të Rënda kanë filluar përgatitjen e dosjeve, të cilat do ti kalojnë për hetim SPAK.

Megjithëse është deklaruar një numër prej 170 dosjesh të cilat do ti kalojnë për kompetencë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kryetari i KLP ka deklaruar gjatë muajit tetor gjatë raportimit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Parlament një ngarkesë prej 55 dosjesh (440 në total) për secilin prej 8 prokurorëve të posaçëm.

Të njëjtat hapa janë ndërmarrë edhe nga Gjykatat e Krimeve të Rënda, të cilat me ngritjen e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të pushojnë së funksionuari. Për këtë arsye drejtuesit e këtyre institucioneve në bashkëpunimin me stafet respektive kanë filluar inventarizimin e dosjeve për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të cilat pritet ti kalojnë për shqyrtim së shpejti Gjykatave të Posaçme KKKO.

Aktualisht në Gjykatat e Krimeve të Rënda janë 20 dosje me mbi 212 të pandehur në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatave kriminale si edhe 10 çështje në kuadër të veprës penale të korrupsionit. Gjithashtu janë 24 procedime për grupe të strukturuar kriminale, të cilat janë në hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

Me krijimin e Gjykatave të Posaçme KKKO do të ngrihet një Komision, i cili do të bëjë verifikimin e punonjësve aktualë në Gjykatat e Krimeve të Rënda sa i përket plotësisht të kushteve të sigurisë dhe kufizimit të privatësisë. Vetëm pas këtij hapi do të jetë i mundur të realizohet konfirmimi në detyrë i punonjësve të administratës gjyqësore në Gjykatat e Posaçme KKKO.

Ndërkohë, procesi i rivlerësimit ende nuk ka përfunduar për 10 gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda (Shkallës së Parë dhe Apelit), kandidatë për në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe ende janë në proces rivlerësimi 2 kandidatë aplikantë për prokurorë të posaçëm.

Për këtë arsye, për ngritjen e njëkohshme të Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nevojitet një koordinim në drejtim të ritmeve të seancave dëgjimore për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda, të cilët janë kandidatët kryesorë për të kaluar në Gjykatat e Posaçme me ritmet e seancave dëgjimore për kandidatët prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.

Një numër prej 440 çështjesh në hetim pritet ti kalojë për kompetencë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Aktualisht në Gjykatat e Krimeve të Rënda janë 20 dosje me mbi 212 të pandehur në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatave kriminale si edhe 10 çështje në kuadër të veprës penale të korrupsionit.

Me krijimin e Gjykatave të Posaçme KKKO do të ngrihet një Komision, i cili do të bëjë verifikimin e punonjësve aktualë në Gjykatat e Krimeve të Rënda sa i përket plotësisht të kushteve të sigurisë dhe kufizimit të privatësisë.

Procesi i rivlerësimit ende nuk ka përfunduar për të gjithë gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda (10) kandidatë për në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe ende janë në proces rivlerësimi 2 kandidatë aplikantë për prokurorë të posaçëm.

Për ngritjen e njëkohshme të Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nevojitet një koordinim në drejtim të ritmeve të seancave dëgjimore për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda, me ritmet e seancave dëgjimore për kandidatët prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.



Këshilli i Lartë i Prokurorisë përmbyll procedurën për ngritjen në detyrë dhe emëron 8 (tetë) prokurorët e parë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Këshilli i Lartë i Prokurorisë renditi në mbledhjen e datës 16 korrik 2019, 15 kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Emrat, të cilët u listuan bazuar në kriteret, aftësitë profesionale, hetimin e çështjeve të rëndësishme dhe kontributin që secili prej tyre ka dhënë në sistemin e drejtësisë ishin kandidatët kryesorë për tu emëruar në Prokurorinë e Posaçme duke

përfshirë edhe konfirmimin e tyre në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (për vendimet e ankimuar).

Deri në fund të muajit tetor 2019, nga 15 kandidatët në garë për prokurorë të posaçëm vetëm 11 prej tyre iu nënshtruan procesit të rivlerësimit, ndërkohë që 4 kandidatët e tjera ende nuk ishin paraqitur në seancat dëgjimore të Komisionit. Për këtë arsye Komisioni i

Posaçëm për ngritjen e SPAK pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë propozoi në mbledhjen e datës 25 tetor 2019, disa hapa (të miratuara unanimisht nga anëtarët e Këshillit.) në funksion të konstituimit të Prokurorisë së Posaçme (SPAK), me qëllim realizimin e tyre brenda një periudhe kohore 30 ditore, brenda muajit nëntor 2019.

Propozimet e Komisionit të Posaçëm përfshinë:

- I. Përmbylljen brenda 30 ditëve (brenda muajit nëntor 2019) të procedurës për ngritjen në detyrë për 8 prokurorët kandidatë për Prokurorinë e Posaçme dhe emërimin e tyre;
- II. Përgatitjen e akteve të nevojshme për miratim, të cilat përfshinë:
 - ✎ Vendimet për emërimin e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme;
 - ✎ Vendimin për caktimin e përhershëm të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me mandat 3 vjeçar nga 8 prokurorë të emëruar në Prokurorinë e Posaçme;
 - ✎ Ndërprerjet e caktimeve të përkohshme për prokurorë që janë të emëruar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe ushtrojnë detyrën pranë një prokurorie tjetër;
 - ✎ Ndërprerjet e caktimeve të përkohshme për prokurorë që janë të caktuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda por janë emëruar pranë një prokurorie tjetër.
- III. Autorizimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për koordinimin e punës me Këshillin e Lartë Gjyqësor për të marrë në mënyrë të njëkohshme vendimet përkatëse për Gjykatën e Posaçme dhe Prokurorinë e Posaçme.
- IV. Hapjen e menjëhershme të garës nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për shprehjen e interesin nga ana e 8 prokurorëve tashmë të emëruar për pozicionin e drejtuesit për një mandate 3-vjeçar (fazë e cila është parashikuar të zgjasë 5 ditë).

Bazuar në propozimet më lart, në mbledhjen e datës 25 nëntor, e cila u zhvillua edhe me praninë e përfaqësuesve ndërkombëtarë të EURALIUS dhe OPDAT, KLP miratoi projekt-aktet për emërimin e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme, përkatësisht: Altin Dumani, Arben Kraja, Behar Dibra, Edvin Kondilli, Elida Çelami (Kaçkini), Ened Nakuçi, Enkeleda Millonai dhe Klodian Braho. 8 prokurorët e emëruar në Prokurorinë e Posaçme, do të kryejnë betimin në datën 19 dhjetor 2019 para Presidentit të Republikës, vendim i cili hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Kandidatët e renditur për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme (16 korrik 2019)	Statusi i vetting -ut	Kandidatët, të cilët u emëruan prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (25 nëntor 2019)
1. Altin Dumani	Konfirmuar në detyrë	1. Altin Dumani
2. Anton Martini	Në proces rivlerësimi	2. Arben Kraja
3. Elizabeta Imeraj	Në proces rivlerësimi	3. Behar Dibra
4. Arben Kraja	Konfirmuar në detyrë	4. Edvin Kondilli
5. Doloreza Musabelliu	Konfirmuar në detyrë	5. Elida Çelami (Kaçkini)
6. Klodian Braho	Konfirmuar në detyrë	6. Ened Nakuçi
7. Enkeleda Millonai	Konfirmuar në detyrë	7. Enkeleda Millonai
8. Marjola Kajana	Konfirmuar nga KPK/Ankimuar	8. Klodian Braho
9. Edvin Kondilli	Konfirmuar në detyrë	
10. Ened Nakuçi	Konfirmuar në detyrë	
11. Elida Kaçkini	Konfirmuar në detyrë	
12. Ndirni Tavani	Shkarkuar nga detyra	
13. Behar Dibra	Konfirmuar nga KPK	
14. Anita Jella	Konfirmuar nga KPK	
15. Besnik Muçi	Konfirmuar nga KPK/Shkarkuar nga KPA	

* Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (www.kpk.al), Institucioni i Komisionerëve Publikë (www.ikp.al) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (www.kpa.al)

Pavarësisht se ligji parashikon përbërjen e Prokurorisë së Posaçme me të paktën 10 prokurorë dhe megjithëse respektimi i këtij numri ka qenë në mënyrë të vazhdueshme një çështje për diskutim edhe brenda vetë KLP-së, duke theksuar se emërimi i më pak se 10 prokurorëve të posaçëm nuk do të sjellë fillimin e funksionimit të SPAK. Organigrama dhe numri i prokurorëve të posaçëm për fillimin e punës së institucionit do të përcaktohen vetëm nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili do të zgjidhet nga rradhët e prokurorëve të posaçëm, menjëherë pas emërimit të tyre.

Në këtë mënyrë, me emërimin e 8 prokurorëve të posaçëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë në po të njëjtën mbledhje të datës 25 nëntor ka hapur zyrtarisht garën për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke shpallur thirrjen për shprehje interesi të prokurorëve të emëruar brenda një afati kohor prej 15 ditësh deri në datën 10 dhjetor 2019.

16 korrik 2019	25 tetor 2019	25 nëntor 2019	10 dhjetor 2019
KLP rendit 15 prokurorët kandidatë për Prokurorinë e Posaçme	KLP fillon procedurën për ngritjen në detyrë të 8 prokurorëve ve të posaçëm	KLP emëron 8 prokurorët në Prokurorinë e Posaçme dhe shpall garën për Drejtues të SPAK	Përfundon aplikimi për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme

Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të përmbyllë në këtë mënyrë, një nga fazat më të rëndësishme në drejtim të ngritjes së Prokurorisë së Posaçme, e cila do të vijojë me përmbushjen e hapave të tjerë ligjorë me qëllim fillimin sa më të shpejtë të veprimtarisë dhe funksionimit të institucionit kryesor të hetimit në vend.

1. Kandidati Besnik Muçi u emërua nga Presidenti i Republikës në 15 tetor 2019 gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, duke u përjashtuar nga gara për prokuror në Prokurorinë e Posaçme KKKO: <http://president.al/presidenti-meta-dekretion-emerimin-e-zotit-besnik-muci-gjyqtar-te-gjykatës-kushtetuese/>
Ndërkohë subjekti u shkarkua nga detyra me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në datën 21.11.2019: <http://kpa.al/njoftim-vendimi-38/>

Me emërimin e 8 prokurorëve të posaçëm KLP hap garën për zgjedhjen e Drejtuesit të SPAK: Anëtarët e Këshillit kanë miratuar metodologjinë për përzgjedhjen e prokurorëve të emëruar, të cilët do të shprehin interesin për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme

Zgjedhja e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme është gjithashtu një hap mjaft i rëndësishëm për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë të këtij organi. Për këtë qëllim, me shpalljen e garës për shprehjen e interesit për këtë pozicion nga 8 prokurorët e posaçëm të emëruar nga KLP, Këshilli ka miratuar nëpërmjet Vendimit Nr. 237 të datës 25.11.2019 edhe metodologjinë që do ndiqet për sa i përket përzgjedhjes së drejtuesit të SPAK, me qëllim orientimin e anëtarëve të KLP në vlerësimin e kandidatëve për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme.

Përveç dokumentacionit që u kërkohet kandidatëve dhe mënyrës së administrimit të tyre, bazuar në rregulloren më lart, kandidatët për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme do të vlerësohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në plotësimin e 7 kriterëve mbi të cilat do të realizohet përzgjedhja e Drejtuesit të SPAK duke përfshirë:

1. Eksperiencën në ndjekjen e çështjeve sensitive;
2. Eksperiencën dhe aftësinë në organizim dhe drejtim strukture;
3. Eksperiencën në hartimin e rregulloreve dhe çështjeve administrative;
4. Eksperiencën në çështje me ndjeshmëri të lartë publike ku është dashur edhe bashkëpunimi me median;
5. Eksperiencën në menaxhimin e burimeve njerëzore;
6. Vizioni dhe plani që do të ndjekin për krijimin e Prokurorisë së Posaçme;
7. Imazhi publik i kandidatëve.

Kandidatët për Drejtues të SPAK do të vlerësohen me 0 deri në 3 pikë në 7 kriteret e sipërcituara të paracaktuara në metodologjinë e vlerësimit. Ndërkohë, përveç kriterëve më lart, Këshilli ka vendosur një instrument shtesë vlerësimi, i cili lidhet me intervistat me kandidatët për drejtues të SPAK sipas datave dhe renditjes së paracaktuar paraprakisht. Këto të fundit do të jenë një instrument i vlerësimit në tërësinë e figurës publike të kandidatëve, përveç 7 kriterëve të paracaktuara me ligj dhe në metodologjinë e vlerësimit. Megjithatë, intervista nuk do të jetë pjesë e pikëzimit.

Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme do të zgjidhen për një mandat 9 vjeçar pa të drejtë riemërimi dhe Këshilli ka propozuar që çdo anëtar të votojë secilin kandidat për drejtues të SPAK duke shpjeguar pikëzimin e tij për çdo kandidat, në një formular pikëzimi pas momentit që do të njihen me platformën konkurruese të secilit. Vetë kryetari i KLP ka propozuar që zgjedhja e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme të kalojë nga Këshilli, jo vetëm si vendimarrje nga Komisioni i Posaçëm në Këshill.

Në përfundim të hapave më lart si edhe intervistave me kandidatët për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme, secili nga anëtarët e Këshillit vlerëson kandidatët sipas formularit bashkëlidhur në metodologjinë e vlerësimit. Maksimumi i pikëve që mund të grumbullojë një kandidat nga secili anëtar i Këshillit është 21.

Anëtari i Këshillit shpjegon masën e përmbushjes së secilit standard nga secili kandidat, vendos vlerësimin përkatës me pikë dhe e lexon atë në mbledhjen e Këshillit të caktuar për zgjedhjen e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Në përfundim realizohet votimi në mënyrë të hapur dhe nominale. Secili nga anëtarët e Këshillit nuk mund të votojë më shumë se një kandidat për Drejtues të SPAK.

STANDARDET E VLERËSIMIT PËR KANDIDATËT PËR DREJTUES TË PROKURORISË SË POSAÇME

	Standardet		Vlerësimi
I.	Eksperiencia në ndjekjen e çështjeve sensitive të korrupsionit dhe krimin të organizuar	Anëtarët e Kës hilli vlerësojnë shpjegimet e kandidatëve në letrën mbështetëse si dhe shfrytëzojnë vlerësimet për kandidatët në fazën e parë, atë të përzgjedhjes si prokurorë të Prokurorisë së Posaçme.	(0-3) pikë
II.	Eksperiencia dhe aftësitë në organizimin dhe drejtimin e një strukture	Ky standard duhet të dokumentohet nga ana e kandidatëve dhe duhet të dëshmojë nëpërmjet rezultateve të arritura në drejtimin dhe organizimin e një strukture. Kës hilli vlerëson në raport me këtë standard: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Eksperiencën drejtuese e vendimmarrëse e kandidatit në të kaluarën; ▪ Nivelin në të cilin kandidati i ka ushtruar kompetencat vendimmarrëse e drejtuese; ▪ Rezultatet e arritura në drejtim/menaxhim. Anëtarët e Kës hilli vlerësojnë gjithashtu argumentet dhe shpjegimet e kandidatit në letrën mbështetëse e për këtë standard.	(0-3) pikë
III.	Eksperiencia në hartimin dhe miratimin e rregulloreve administrative	Në letrën mbështetëse e për këtë standard, kandidatët shpjegojnë sa dhe si janë përfshirë në hartimin dhe miratimin e rregulloreve administrative. Edhe ky standard duhet të dokumentohet nga ana e kandidatëve nëpërmjet akteve që vërtetojnë pjesëmarrjen e 3 tyre në grupe pune për hartimin dhe miratimin e rregulloreve të ndryshme apo akteve të tjera me karakter administrativ.	(0-3) pikë
IV.	Eksperiencia në çështje të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike dhe ndërveprim me median	Përveç letrës mbështetëse e me shpjegimet përkatëse, lidhur me këtë standard, kandidatët mund të sjellin si dokumentacion provues, veç të tjerash edhe publikimet e ndryshme në media për çështje të hetuara apo përfaqësuar prej tyre të cilat kanë tërhequr vëmendjen e publikut dhe medias.	(0-3) pikë
V.	Aftësitë në drejtimin efektiv të burimeve njerëzore	Ky standard është i lidhur ngushtë me standardin 2 i cili vlerëson eksperiencat në drejtimin e një strukture, ku përfshihet edhe menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore. Kandidatët mund të dorëzojnë të njëjtin dokumentacion, duke theksuar që shërben për vlerësimin e dy standardeve. Së bashku me dokumentacionin, kandidatët dorëzojnë edhe letrën shpjeguese për këtë standard.	(0-3) pikë
VI.	Vizioni ose plani i besueshëm për ndërtimin e Prokurorisë së Posaçme si një institucion funksional dhe efektiv	Për vlerësimin e këtij standardi, anëtarët e Kës hilli bazohen në platformën e dorëzuar nga kandidatët sipas nenit 18 të rregullores dhe në prezantimin e saj në sëance dëgjimore. Drejtimet kryesore për vlerësimin e këtij standardi janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ qartësia dhe saktësia e platformës së paraqitur nga kandidati; ▪ qartësia dhe saktësia e kandidatit në identifikimin dhe artikullimin e sfidave që paraqet ushtrimi i detyrës së drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme; ▪ qartësia dhe saktësia e kandidatit në identifikimin dhe formulimin e ideve/planeve për adresimin e sfidave. Lidhur me vlerësimin e këtij standardi, nuk është e nevojshme të paraqiten dokumente shtesë, përveç platformës së paraqitur në momentin e shprehjes së interesit.	(0-3) pikë
V	Imazhi publik i karrierës së tij/saj si prokuror	Kandidati edhe për këtë standard paraqet një letër mbështetëse. Lidhur me përmbushjen e këtij standardi, kandidatët mund të paraqesin çdo dokument i cili shërben vlerësimin të pamazhit të tyre si prokurorë, përfshirë këtu edhe pjesë të vendimeve të organeve të rivlerësimit, vlerësime nga ana e eporëve të tyre, vlerësime nga institucione apo organizata të ndryshme vendas e apo të huaja etj.	(0-3) pikë

Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall thirrjen për t'u bërë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH): Hapen aplikimet për pozicionin e Drejtorit dhe të hetuesve të BKH-së

Emërimi i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si edhe zgjedhja e Drejtuesit të këtij organi përbëjnë një hap të rëndësishëm edhe në drejtim të realizimit të një sërë procesesh të tjera ligjore në funksion të ngritjes të të gjitha strukturave të parashikuara në legjislacion. Të 8 prokurorët e emëruar nga KLP mund të shfaqin interesin e tyre për pozicionin e Drejtuesit të këtij organi brenda datës 10 dhjetor 2019. KLP, nëpërmjet një votimi të hapur dhe nominal zgjedh Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme në mbledhjen e tij më të afërt. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme do të ketë një rol thelbësor në administrimin e Prokurorisë së Posaçme dhe aspekteve më të rëndësishme të institucionit për 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje. Ndërkohë duhet theksuar që edhe pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, KLP mund të rihapë thirrjen për aplikime në rast se ka nevojë për më tepër anëtarë.

Përveç zgjedhjes së Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, një hap tjetër i rëndësishëm është edhe ngritja e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), një strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme dhe përbëhet nga Drejtori, hetuesit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore. Në këtë mënyrë, KLP ka filluar paraprakisht procedurat për ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit duke publikuar në faqen e institucionit një informacion për të interesuarit për t'u bërë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) për pozicionet e Drejtorit dhe hetuesve të BKH-së, numri i të cilëve është përcaktuar të jetë 60.

Bazuar në këtë njoftim, por edhe në kërkesat e legjislacionit përkatës, fillimisht, kandidatët për Drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kushtet e sigurisë, të cilat përfshijnë:

- ✎ kontrollin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës;
- ✎ dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake; si dhe
- ✎ dhënien e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit është përgjegjës për funksionimin e BKH dhe përzgjedhja e tij/saj realizohet nëpërmjet një komisioni të përbërë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë të posaçëm me më shumë vite eksperiencë pune si prokuror, pas një procesi rekrutimi të hapur dhe transparent. Komisioni rekomandon një kandidat për Drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili emërohet nga KLP për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë.

Kriteret fillestare:

- ✎ shtetas shqiptar;
- ✎ ka arsim të lartë policor, në drejtësi apo kontabilitet, ose arsim të lartë në degë të tjera që kanë lidhje me misionin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, nga një universitet vendas apo i huaj;
- ✎ ka një përvojë më shumë se 1-vjeçare pune në institucionet e zbatimit të ligjit ose në një fushë tjetër që lidhet me qëllimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit;
- ✎ të ketë plotësuar me sukses kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit për Byronë Kombëtare të Hetimit.


Fazat e përzgjedhjes:

- ✎ plotësimin e një aplikimi online, përfshirë një curriculum vitae elektronike dhe dokumentet mbështetëse, si dhe një deklaratë me shkrim mbi motivimin për t'u bërë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit;
 - ✎ një provim me shkrim e me gojë, ku përfshihen teste konjitive, të sjelljes dhe të arsytimit logjik;
 - ✎ një provim të zgjeruar me shkrim që mat aftësitë e shkrimit të raporteve, si dhe nivelin e shkrimit e leximit;
 - ✎ një intervistë nga një komision që mat aftësitë e komunikimit verbal, si dhe aftësinë për t'i komunikuar idetë me efikasitet;
 - ✎ një testim të aftësive fizike që mat forcën dhe rezistencën fizike;
 - ✎ një hetim mbi verifikimin e figurës, i cili konfirmon se personi nuk është dënues dhe nuk është shpallur më parë fajtor për vepra penale; dhe
 - ✎ të ketë dhënë pëlqimin për t'iu nënshtruar testit të poligrafit rreth integritetit të kandidatit.
- Informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit merret në konsideratë gjatë procesit të emërimit dhe atij të riemërimit.

Trajnimi dhe Arsimimi:

Ti nënshtrohet një regjimi rigoroz trajnimi dhe arsimimi, me një sërë modulesh vlerësimi që duhen kaluar përpara se të certifikohet si i trajnuar dhe i aftë dhe të konsiderohet hetues.

Të njëjtat kushte dhe kritere janë parashikuar edhe në përzgjedhjen e hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë përgjegjës për hetimin, gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore dhe kryejnë hetime vetëm nën drejtimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme. Emërimi i tyre në Byrosë Kombëtare të Hetimit bëhet nga Drejtori i BKH, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.



** Hapat ligjorë për zgjedhjen dhe emërimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme KKKO, Drejtorit dhe hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH)*

Gjykatat dhe Prokuroritë e Krimeve të Rënda përgatisin dosjet në kompetencë të Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme: 30 dosje në Gjykatat e Krimeve të Rënda me 212 të pandehur janë gati për në Gjykatat KKKO dhe 440 dosje do ti kalojnë për hetim SPAK

Paralelisht me procesin e emërimit të 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme dhe hapjen e thirrjes për zgjedhjen e Drejtuesit të këtij institucioni, Prokuroritë e Krimeve të Rënda kanë filluar përgatitjen e dosjeve, të cilat do ti kalojnë për hetim SPAK. Sipas raportimit të Kryetarit të KLP në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Parlament, Prokuroria e Posaçme parashikohet të ketë një ngarkesë prej 440 dosjesh, 55 për secilin prej 8 prokurorëve të posaçëm.

Prokurorisë së Posaçme do t'i kalojnë për kompetencë edhe dosje të Prokurorive të Rretheve, të cilat lidhen me veprat e hetimit të korrupsionit dhe krimin të organizuar për të zgjedhurit vendorë apo zyrtarë të tjerë të lartë. Ndërkohë problematike konsiderohet lëvizja e rreth 12 prokurorëve aktualë të krimeve të rënda, të cilët nuk do të jenë pjesë e SPAK dhe të cilët do të emërohen në vendet vakante të Prokurorive të Rretheve të krijuara nga procesi i vetting-ut.

Disa nga dosjet më të nxehta dhe që priten të hetohen nga SPAK janë, "Dosja 339" ku përfshihen dhe akuzat për korrupsion apo shitblerja e votave, dy rastet e trafikut të kokainës, me 613 dhe 137 kg, dosja Bajri", apo dhe dosje të trafikut të klandestinëve. Me nisjen e punës së SPAK, 8 prokurorët duhet të hartojnë gjithashtu edhe listën me emrat e personave të cilësuar me rrezikshmëri të lartë që do ti nënshtrohen izolimit nga sistemi 41-bis. Katër muaj më parë, janë akorduar 1.2 milionë Euro për ngritjen e Strukturës së Posaçme që do të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Të njëjtat hapa janë ndërmarrë edhe nga Gjykatat e Krimeve të Rënda, të cilat me ngritjen e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar do të pushojnë së funksionuari. Për këtë arsye drejtuesit e këtyre institucioneve në bashkëpunimin me stafet respektive kanë filluar inventarizimin e dosjeve për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të cilat priten ti kalojnë për shqyrtim së shpejti Gjykatave të Posaçme KKKO.

Aktualisht në Gjykatat e Krimeve të Rënda

janë 20 dosje me mbi 212 të pandehur në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatave kriminale si edhe 10 çështje në kuadër të veprës penale të korrupsionit. Gjithashtu janë 24 procedime për grupe të strukturuar kriminale të cilat janë në hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.


Gjykata e Krimeve të Rënda si institucioni përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e godinës, ka përshtatur sistemin e ri të sigurisë me të gjitha elementet e reja duke ridimensionuar sistemin e kamerave të vëzhgimit, sistemin e identifikimit të hyrjeve të paautorizuara, sistemin e sinjalistikës akustike dhe aksesit të hyrje-dalje në institucion.

Ndërkohë, përveç vendimit të Këshillit të Ministrave për kushtet e sigurisë në godinën ku do të vendosen SPAK dhe Gjykatat e Posaçme KKKO, janë dizenuar tabelat si dhe ka përfunduar instalimi në të gjithë perimetrin të godinës me kamera sigurie si dhe aparatura të tjera bashkohore, të cilat do të monitorojnë sistemin e sigurisë në ambientet e Gjykatave të Krimeve të Rënda. Masa të tilla do të aplikohen edhe me ngritjen e institucioneve të reja kundër

korupsionit dhe krimin të organizuar.

Gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i transformimit të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykata të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar lidhet edhe me stafin teknik dhe administrativ, i cili gjithashtu do t'i nënshtrohet plotësisht të kushteve të sigurisë të përcaktuara në legjislacion. Respektivisht, me krijimin e Gjykatave të Posaçme KKKO do të ngrihet një Komision, i cili do të bëjë verifikimin e punonjësve aktualë në Gjykatat e Krimeve të Rënda sa i përket plotësisht të kushteve të sigurisë dhe kufizimit të privatësisë. Vetëm pas këtij hapi do të jetë i mundur të realizohet konfirmimi në detyrë i punonjësve të administratës gjyqësore në Gjykatat e Posaçme KKKO.


Koordinimi i hapave dhe veprimtarive të dy Këshillave, si edhe harmonizimi dhe marrja e masave nga institucionet kryesore aktuale siç janë Gjykatat dhe Prokuroritë e Krimeve të Rënda është i rëndësishëm për konstituimin e njëkohshëm të organeve të reja kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.



* Afatet ligjore për ngritjen e strukturave të Gjykatave të Posaçme KKKO dhe emërimin e punonjësve.

Procesi i rivlerësimit ende nuk ka përfunduar për të gjithë gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar: Ndërkohë ende janë në proces rivlerësimi 2 kandidatë aplikantë për prokurorë të posaçëm



Vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA) do të përcaktojnë emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm në institucionet e reja të gjyqimit dhe hetimit për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për këtë arsye, për ngritjen e njëkohshme të Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nevojitet një koordinim në drejtim të ritmeve të seancave dëgjimore për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda, të cilët janë kandidatët kryesorë për të kaluar në Gjykatat e Posaçme me ritmet e seancave dëgjimore për kandidatët prokurorë në Prokurorinë e Posaçme. Megjithatë Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar 8 prej kandidatëve për prokurorë të posaçëm, të cilët kanë janë konfirmuar në detyrë në të dyja shkallët e rivlerësimit, përcaktimi në vijimësi i strukturës së Prokurorisë së Posaçme nga Drejtuesi i këtij organi, mund të sjellë nevojën për aplikimin e kandidatëve të tjerë prokurorë, për të cilët vendimet e KPK dhe KPA do të jenë të detyrueshme.



* Ritmet e Seancave Dëgjimore për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda dhe prokurorët kandidatë në Prokurorinë e Posaçme (Korrik 2018 - Dhjetor 2019), Burimi: Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, (www.kpk.al)

Sikurse edhe në rastin e prokurorëve të posaçëm, legjislacioni parashikon një numër të caktuar gjyqtarësh të posaçëm, specifikisht 16 gjyqtarë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe 11 gjyqtarë në Gjykatën e Posaçme të Apelit. Mundësia e mosplotësimit të numrit të caktuar të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme është pohuar edhe nga vetë drejtues të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Zv/Kryetari i KLGJ ka theksuar problematikën e numrit të lartë të shkarkimeve, e cila mund të sjellë mosplotësimin e vendeve vakante në Gjykatat e Posaçme, veçanërisht atë të apelit, duke rrezikuar si pasojë mos ngritjen e këtyre institucioneve dhe krijimin e vonesave të tjera.

Megjithëse funksionimi i Gjykatave të Posaçme është parashikuar të fillojë edhe me emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve aktualë të krimeve të rënda, faktorë të tjerë si numri i lartë i shkarkimeve nga detyra apo vendimeve të ankimuar do ta bënin të pamundur vazhdimin e funksionit të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme. Për ti paraprirë vonesave që mund të vijnë si rezultat i numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve KPK dhe KPA duhet të përshtjetojnë ritmet e rivlerësimit kalimtar të kandidatëve për emërim në Gjykatat e Posaçme, pasi rezultatet e vendimeve të marra për gjyqtarët aktualë do të përcaktojnë numrin e vendeve vakante në këto Gjykata. Kjo do t'i mundësojë KLGJ shpalljen e vendeve vakante për të plotësuar numrin e nevojshëm të gjyqtarëve të parashikuar në ligj për ngritjen e Gjykatave të Posaçme.



* Vendimet e dhëna nga KPK për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda dhe 14 kandidatët për prokurorë të posaçëm.



KY BULETIN REALIZOHET NË KUADËR TË PROJEKTIT: FORCIMI I INFORMIMIT DHE PJESMARRJES SË PUBLIKUT NË ZBATIMIN E REFORMËS NË DREJTËSI NËPËRMJET MONITORIMIT, VLERËSIMIT DHE KOMUNIKIMIT TË PROCESIT TË NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Projekt i financuar nga:

Fondacioni

Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Gjatë periudhës Shtator 2019 – Nëntor 2019 Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) do të punojë për zbatimin e projektit të mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë “ Forcimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe komunikimit të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Reforma në sistemin e drejtësisë është një nga reformat më të thella dhe gjithëpërfshirëse të ndërmarra në Shqipëri në vitet e fundit, e cila synon të adresojë problemin e hetimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të evidentuara ndër pengesat kryesore për zhvillimin e metejshëm ekonomik shoqëror të vendit dhe për antarësimin në Bashkimin Evropian. Një nga komponentët kryesorë të kësaj reforme është ngritja e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PROJEKTIN

Kohëzgjatja	Korrik 2019 – Prill 2020
Programi/ Fusha e zbatimit	Programi i Reformës në Drejtësi financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
Nevoja e zbatimit të këtij Projekti	Nevoja për informim mbi proceset e ndërmjetme ligjore dhe administrative, përcaktuese për ecurinë dhe finalizimin e krijimit të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK si dhe nevoja më shumë komunikim dhe mbështetje në drejtëm të ngritjes së kapaciteteve administrative dhe njerëzore për fillimin e ushtrimit të kompetencave të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK.
Qëllimi i Projektit	Qëllimi kryesor i projektit është monitorimi, vlerësimi dhe mbështetja në vazhdimësi e procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ku përfshihen Gjykatat e Posaçme dhe SPAK.
Objektivat e Projektit	Objektivat specifikë të projektit janë: <ul style="list-style-type: none"> • Të monitorojë dhe vlerësojë procesin e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, përfshirë zbatimin e kompetencave të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në krijimin e Gjykatave të Posaçme dhe SPAK. • Të informojë dhe ndërgjegjësojë qytetarët dhe palët të interesuara mbi procesin e krijimit dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. • Të ndërveprojë me palët e interesuara nëpërmjet advokimit dhe mbështetjes së autoriteteve shtetërore përgjegjëse për zbatimin e reformës në drejtësi. • Të forcojë mbështetjen dhe besimin e publikut për institucionet e reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe të vendosë një standardi të ri komunikimi dhe ndërveprimi me Gjykatat e Posaçme dhe SPAK.
Instrumentat dhe mekanizmat	Gjatë zbatimit të projektit dhe monitorimit, vlerësimit dhe mbështetjes së institucioneve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, do të përdoret një kombinim i metodave, në përputhje me aktivitetet e parashikuara, të cilat do të jenë: (1) hulumtuese, (2) monitoruese (3) advokuese dhe (4) komunikuese.
Institucionet e reformës në drejtësi, fokusi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Gjykata e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar • Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar • SPAK një strukturë e cila përbëhet nga dy komponentë: <ul style="list-style-type: none"> • Prokuroria e Posaçme • Byroja Kombëtare e Hetimit
Produktet e Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e katër Buletineve Informuese, një në çdo tre muaj, nën titullin “SPAK Monitor” • Përgatitja e Broshurave Informative, në çdo dy-tre javë, nën titullin “SPAK Info” • Përgatitja e një Plani Komunikimi • Përgatitja dhe prezantimi i Web Project – SPAK • Hartimi i Strategjisë së Angazhimit të Palëve të Interesit (SAPI) • Përgatitja dhe shpërndarja e dy spoteve audiovizuale sensibilizuese e informuese • Zhvillimi i 3 Tryezave Tematike
Rezultatet e pritshme	Rezultatet e pritshme të projektit janë: <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i saktë dhe gjithëpërfshirës i të gjitha hapave ligjore dhe administrative për ngritjen e Gjykatave të Posaçme dhe SPAK. • Përmirësimi i informimit të qytetarëve, por edhe aktorëve të tjerë duke synuar të forcojë angazhimin e tyre dhe advokimin për çështje specifike të lidhura me ecurinë e ngritjes dhe funksionimit të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK. • Vendosija e kontakteve ndërvepruese dhe hartimi i planeve të komunikimit me institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, me qëllim përmirësimin e komunikimit dhe pjesëmarrjes si edhe ofrimin e mbështetjes ndaj tyre.
Përfituesit kryesorë	Përfituesit kryesorë të projektit do të jenë: <ul style="list-style-type: none"> • Institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ku përfshihen Gjykatat e Posaçme dhe SPAK. • Në kuadër të komponentit të komunikimit, do të jenë përfitues gjithashtu edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organe kryesore për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm. • Organizata, media, ekspertë, gazetarë, institucione shtetërore dhe ndërkombëtare si edhe qytetarët dhe publiku i gjerë do të përfitojnë në kuadër të projektit nëpërmjet një informimi më të mirë dhe gjithëpërfshirës të proceseve, pjesëmarrjes aktive në ndjekjen e zbatimit të hapave ligjorë për ngritjen e gjykatave të Posaçme dhe SPAK si edhe advokimit për të adresuar apo diskutuar çështje të rëndësishme të evidentuara gjatë zbatimit.